



Nr. 427 Prot.

Tiranë, më 5 settembre 2023

**Procedurat e pranimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të ciklit të dytë**

**Viti akademik 2023 -2024**

**I. Kuotat dhe kriteret e pranimit**

Kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;
- të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 436, datë 03.06.2020 të Republikës së Shqipërisë për vitin akademik 2023 -2024, sipas të cilit nota mesatare duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 6.5 (referuar sistemit arsimor shqiptar);
- nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht më shumë se një program studimi në të njëjtin vit akademik, në universite publike dhe/ose jopublike, shqiptare dhe/ose të huaja;
- duhet të kryejnë procedurën e njëvlershmërisë së diplomës së shkollës së mesme pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore të Republikës së Shqipërisë deri në dt. 30 mars 2024.

Sipas Udhëzimit Nr. 12 dt. 30.06.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në përputhje me Urdhërin e përbashkët Nr. 10, dt. 10.07.2023, kandidatët nga Republika e Kosovës dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci **aplikojnë pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në datat 2 deri në 13 shtator 2023.**

Kuotat e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë për kandidatë nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci, Medvegja i gjeni ne tabelën e mëposhtme:

<b>Programi i studimit</b>	<b>Kuotat e pranimit</b>
Ekonomi Ndërmarrjeje	5
Infermieristikë	2
Fisioterapi	2
Mjekësi	5
Odontoiatri dhe Proteza Dentare	5
Farmacit	3
Arkitekturë	5

**II. Regjistrimi/matrikullimi**

Sipas Udhëzimit nr. 12, dt. 30. 06. 2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), të gjithë kandidatët që janë shpallur fitues në testimet e pranimit të raundit të parë duhet të regjistrohen pranë Sekretarisë Mësimore **Në datat 26**

**shtator deri në 03 tetor 2023.** Kandidatit të shpallur fitues, i dërgohet një e-mail nga Sekretaria Mësimore ku i komunikohen dokumentet e nevojshme për regjistrim dhe afati regjistrimit. Kur kandidati është shpallur fitues, ai duhet të paraqitet pranë Sekretarisë Mësimore brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit, ai humbet të drejtën e regjistrimit dhe Sekretaria Mësimore thërret automatikisht kandidatin tjetër. Këto faza vijnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën **10 tetor 2023**. Nëse pas përfundimit të listës së renditjes, do të mbeten ende kuota të paplotësuara dhe nuk do të ketë kandidatë në pritje, do të rikthehen në garë kandidatet e shpallur fitues të cilët nuk janë paraqitur për regjistrim në fazat paraardhëse dhe nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi.

### III. Pjesëmarrja në testimin e pranimit

Për të aplikuar në degwt Mjekesi, Odontoiatri, Infermieristikë, Arkitekturë, Fisioterapi, Farmaci dhe Ekonomi Ndërmarrjeje, kandidatët duhet të regjistrohen on line në portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/> , në **datat 04 shtator deri në 13 shtator 2023**, duke ngarkuar dokumentacionin e mwposhtwm nw format PDF:

1. kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton njohjen e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, shoqëruar me kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim të diplomës;
2. kopje të njehsuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë dhe të përkthyer në gjuhën shqipe (nëse është lëshuar në gjuhë të huaj) të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet.
3. dokument identifikimi;

Për të marrë pjesë në teste, nga data **4 shtator 2023 deri 13 shtator 2023 ora 16: 30**, kandidatët duhet të:

1. dërgojnë me e-mail në adresën elektronike: [info@unizkm.al](mailto:info@unizkm.al) kopjen e kartës së identitetit duke specifikuar atësinë dhe një nr. telefoni;
2. paguajnë tarifën e regjistrimit në testim prej 2.000 lekë si më poshtë:
  - pranë filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë<sup>1</sup> me këto të dhëna:  
Përfituesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)  
1. IBAN AL60208112040000030694935302 për pagesat në Euro;  
2. IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.
  - me kartë krediti online në portalin universitar në adresën elektronike:  
<https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>
  - pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30.

Duke marrë parasysh numrin e kufizuar të kuotave për këtë kategori kandidatësh, aplikuesit mund t'i nënshtrohen seleksionimit në datën **16 shtator 2023** sipas programeve të studimit për të cilat kanë aplikuar:

Pjesëmarrësit duhet të paraqiten pranë Sekretarisë Mësimore të paktën 30 minuta përpara fillimit të testimit përkatës dhe duhet të jenë të pajisur me një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Gjatë zhvillimit të testimit është i ndaluar përdorimi apo mbajtja e mjeteve elektronike të komunikimit (telefonë celularë, I-Phone, I-Pad, etj.). Në rast konstatimi, pjesëmarrësit do të përjashtohen menjëherë nga testimi.

- **Për programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë**, seleksionimi konsiston në një vlerësim të kombinuar të rezultateve të shkollës së mesme, njohurive të gjuhës italiane dhe njohurive në Shkencat Natyrore (Biologji, Fizikë, Kimi e Matematikë) në gjuhën italiane.

---

<sup>1</sup> Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e testimit duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.

Program i studimit	Data	Ora
Program i integruar i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në <i>Mjekësi</i>	16/09/2023	11:00
Program i integruar i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	16/09/2023	11:00
Program i studimit "Bachelor" në <i>Fizioterapi</i>	16/09/2023	11:00
Program i studimit "Bachelor" në <i>Infermieristikë</i>	16/09/2023	11:00

- **Për programin e studimit në Arkitekturë**, përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nëpërmjet kriterëve të mëposhtme:

- Testim me shkrim, në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë e kulturës së përgjithshme të zotëruar nga kandidati **dhe do të zhvillohet dt. 16 ora 11:00;**
- Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme.

- **Nuk do të zhvillohen teste pranimit për kandidatët që aplikojnë për programet e studimit në Ekonomi Ndërmarrjeje dhe Farmaci.** Për këto programe studimi renditja e kandidatëve do bëhet sipas mesatares së përgjithshme të shkollës së mesme.

Listat e renditjes së kandidatëve do të kryhen në bazë të rezultateve përfundimtare individuale, sipas renditjes së pikëve të fituara dhe do të publikohen në ambientet e Universitetit dhe në faqen zyrtare: [www.unizkm.al](http://www.unizkm.al) në datën **18 shtator 2023.**

**Për t'u regjistruar, kandidatët e shpallur fitues duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre përveç dokumentacionin të dorëzuar në momentin e regjistrimit dhe dokumentacionin e mëposhtëm:**

- Mandatpagesë nga Banka për shlyerjen e kështit të parë ose të kështit të plotë të tarifës vjetore<sup>2</sup> të studimit (Urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë shkarkohet nga portali studentit: [portal.unizkm.al](http://portal.unizkm.al), zëri "Tariffe");
- Formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2 pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- 6 dy fotografi;

**Dokumentacioni duhet të jetë fotokopje e noterizuar. Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj duhet të jetë i pajisur edhe me vulë Apostile.**

Kandidatët që e kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit të cilët do të kenë mangësi në dorëzimin e dokumentit do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë. Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik. Kandidatët fitues me diplomë të huaj, në këto programe studimi, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, si të gjithë kandidatët e tjerë, por regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, pa pasur domosdoshmërisht në momentin e regjistrimit dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga QSHA.

Rektori  
**Leonardo Palombi**



<sup>2</sup> Në rastet kur kandidati plotëson kushtet e parashikuara në Rregulloren e Tarifave për përfitim të bursës vjetore, detyrimi i tij do të jetë në përputhje me tarifën e mbetur